



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KAVAJË

Nr. _____, Prot.

Kavajë, më 20.05.2019

N J O F T I M
PËR NJË VEND TË LIRË PUNE
(Me afat të pa caktuar)

“Në pozicionin koordinator/e në Prokurorinë e Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë”

Në zbatim të nenit 42 dhe 68 të ligjit nr 97/2016 , “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*“, si dhe të Urdhërit nr. 27, datë 21.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm, njoftoj për një vend të lirë punë për koordinator/e në Prokurorinë e Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

Kandidati për kordinator/e pranë prokurorisë duhen plotësojë këto kërkesa:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar e të folur.
- Të jetë fizikisht i aftë për të kryer detyrën.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë një hetim penal në proces;
- Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit.
- Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për psikologji, sociologji, ose fusha të tjera të ngjashme.
- Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë, ofruesit e shërbimeve, që operojnë në komunitet, viktimat dhe publikun.
- Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive dhe me takt me viktimat emocionalisht të shqetësuara.
- Të ruajë sekretin hetimor.
- Të ruajë konfidencialitetin e informacionit të viktimës.
- Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.
- Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me viktimat e krimit.
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si: Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.

Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:

- Njohja e shërbimeve që u ofrohen viktimave të krimit nga ofruet të ndryshëm shtetërorë dhe jo qeveritarë.
- Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

Të interesuarit duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesë për punësim.
2. C-V të detajuar së bashku me një foto.
3. Diplomë e shkollës së lartë dhe çertifikatë notash.
4. Fotokopje te kartes se identiteti/pasaporte.
5. Dëshmi penaliteti.
6. Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht .
7. Fotokopje te librezës së punës.
8. Vërtetim vendbanimi.
9. Vërtetim-mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Të gjithë dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë ose origjinale, ose fotokopje e noterizuar.

Dokumentët të paraqiten pranë K/Sekretarisë së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, duke filluar nga data 20.05.2019 deri me datë 27.05.2019.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROÇEDURAT E PUNËSIMIT NE PROKURORINË
PRANË GJYKATES SË RRETHIT GJYQËSOR KAVAJE**